



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR

Nr _____Prot

Gjirokastër më _____.____.2025

**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT
FILLOJNË AFATET E ANKIMIMIT**

[15.10.2025]

Drejtuar: BOE

INA shpk me Nr Nipti J61814009W me 89 % , dhe adresa Tirane Rruga Besim Imami,
Myslym Shyri, Mbrapa Karburantit]

EUROBETON shpk me Nr Nipti K23116602P me 11% dhe adresë Gjirokaster Ndane rruges
nacionale Gjirokaster-Kakavie, perballe Varrezave te qytetit Gjirokaster, godine 2-kateshe, nr.
pasurie 19/5, Zona Kadastrale 8543

BOE me Subjekt Mbështetës:

2 N shpk me Nr Nipti L31615017L me adresë Tirane Paskuqan PASKUQAN Lagjja "Paskuqan
Fushe", Rruga "Demokracia", Pallati Nr.2, Kati i Pare

Tipi i Kontratës:Punë

Lloji i Procedurës së prokurimit: e hapur

Numri i Procedurës / referenca e Lotit: **Ref-56498-07-29-2025**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **[Rikonstruksion i godinës ekzistuese dhe shkallës së
emergjencës dhe dhomës teknike në shkollën 9-vjecare « Urani Rumbo»]**

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE:30.07.2025

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike [04.08.2025]
[40]_____

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim ☐ x

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. **BOE: NIKA sh.p.k** me NIPT J76705047U & **B.M-Konstruksion sh.p.k** & me NIPT J66703048R me vlerë të ofertës së ofruar **51 192 903.50 (Pesëdhjetë e një milion e njëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e tre pikë pesë)** lekë pa tvsh
2. **BOE INA shpk** me Nr Nipti J61814009W me 89 % , & **EUROBETON shpk** me Nr Nipti K23116602P me vlerë të ofertës së ofruar **61.957.475,65 [gjashtëdhjetë e një milion e nëntëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e pesë presje gjashtëdhjetë e pesë lekë pa tvsh.**
3. **BOE T&J Construction sh.p.k** me NIPT M29718101T & **VALONA KONSTRUKSION sh.p.k** me NIPT K26330202E & **NDREGJONI sh.p.k** me NIPT K31329048I me vlerë të ofertës së ofruar **65 000 000 (Gjashtëdhjetë e pesë milion)** lekë pa tvsh.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

- (a) **BOE: NIKA sh.p.k** me NIPT J76705047U & **B.M-Konstruksion sh.p.k** & me NIPT J66703048R me vlerë të ofertës së ofruar **51 192 903.50 (Pesëdhjetë e një milion e njëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e tre pikë pesë)** lekë pa tvsh

B.M-Konstruksion” sh.p.k nuk ploteson kushtet e vendosur në DST:

1. **2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022-2023-2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur të kontratës.

Në bazë të nenit 43 pika 3 VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Vlerat e xhiros per vitet financiare 2022-2023-2024 te OE “B.M-Konstruksion” jane më te vogla se vlera e përlllogaritur të kontratës 78.753.168,48 (shtatëdhjetë e tetë milion e shtatëqind e pesqëdhjetë e tre mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e tetë presje dyzetë e tetë) leke pa t.v.sh

2. **2.4** Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministri e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e Vkm nr 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit , klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit :

N.P-1 A Punime gjërmimi në tokë.

N.P-2 A Ndërtime civile dhe industriale

N.P-3 A Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada

N.P-12 A Punime të inxhinierisë së mjedisit.

Për punimet speciale të ndërtimit

N.S.-1 A Punime për prishjen e ndërtimeve

N.S.-2 A Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre.

N.S.-4 B Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese

N.S.- 6 A Sinjalistika rrugore jondriçuese.

NS – 8 A Ndërtime parafabrikat betonarme, struktura metalike dhe druri

N.S.-12 A Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit

N.S.-14 A Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj

OE “B.M-Konstruksion” shpk I mungojne kategorite e meposhtme:

I. N.P-12 A Punime të inxhinierisë së mjedisit

II. NS – 8 A Ndërtime parafabrikat betonarme, struktura metalike dhe druri

Kjo duke marrë parasysh ndarjen e punimeve në preventiv si BOE rezulton se operatori B.M- Konstruksion sh.p.k do të realizojë punime të cilat I përkasin llojit të licencës NP-12 dhe NS-8

3. Oferta e ofruar nga BOE **rezultone e pa sakte:**

Në preventiv tek pjesa **8. PAJISJE JASHTË LISTE/ 3.PUNIMET ELEKTRIKE** janë përsëritur ne brendesi elementët nga nr. 132 deri nr.143,

Ne kete rast nuk përbën **gabim aritmetik** në kuptim të nenit 82, pika 3 a, b c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, pasi nuk kemi të bëjmë me mospërputhje ndërmjet cmimit për njësi apo por përbën **mospërputhje me dokumentet e tenderit**, pasi ndryshon përmbajtjen dhe formën e preventivit të ngarkuar në SPE nga ana e AK.

Sipas nenit 92, pika 1 dhe 3, të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar),

1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohej, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme

Një ofertë e vlefshme vlerësohet vetëm nëse është **në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit**. Përfshirja e zërave shtesë nga OE përbën ndryshim në përmbajtjen e ofertës dhe si e tillë e kthen ofertën në të pavlefshme

4.

- Për punonjësit me profesionet si më sipër cituar, në mënyrë që Autoriteti Kontraktor të ketë mundësinë e verifikimit, operatorët ekonomik ofertues duhet të plotësojnë dhe ngarkojnë tabelën e mëposhtme me të dhënat e sakta që i përkojnë diplomës/certifikatës së formimit profesional nga Institucione Private apo Shteterore.

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Nr i amzës/regjstrit dhe data e lëshimit	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
-----	---------------------------	------------	--	--	--

1					
2					
etj					

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin*”.

(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik secili Operator duhet të disponojë stafin e sipërcituar në varësi të punimeve që ka marrë përsipër të realizojë sipas ndarjes së punimeve.).

OE “B.M-Konstruksion” shpk rezulton mos të ketë paraqitur në SPE tabelën për punonjësit e specializuar përkatësisht për puno jësin Specialist IT sipas deklarimit të bërë në Shtojcën 8 Formulari Përmbledhës I Vetdeklarimit.

5. **2.13** Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Çertifikuar sipas standarteve ISO të leshuara nga organizmat e vleresimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, ose ekuivalente konkretisht:

- a) Certificate ISO 9001:2015 Sistemet e menaxhimit të cilësive/ **ekuivalente dhe e vlefshme**
- b) Certificate ISO 14001:2015 Sistemet e menaxhimit të ambientit / **ekuivalente dhe e vlefshme**
- c) Certificate ISO 45001-2018 (Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë)/ **ekuivalente dhe e vlefshme**
- d) *Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).*

- OE B.M-Konstruksion” sh.p.k **nuk ka paraqitur në SPE kushtet e vendosur në DST** për kriterin 2.13 për paraqitjen e certifikatave ISO

OE “NIKA” sh.p.k rezulton se për pikën e poshtëcitur në Kriteret e vecanta të kualifikimit

- Për punonjësit me profesionet si më sipër cituar, në mënyrë që Autoriteti Kontraktor të ketë mundësinë e verifikimit, operatorët ekonomik ofertues duhet të plotësojnë dhe ngarkojnë tabelën e mëposhtme me të dhënat e sakta që i përkojnë diplomës/çertifikatës së formimit profesional nga Institucione Private apo Shtetërore.

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Nr i amzës/regjstrit dhe data e lëshimit	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
1					
2					
etj					

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik secili Operator duhet të disponojë stafin e sipërcituar në varësi të punimeve që ka marrë përsipër të realizojë sipas ndarjes së punimeve.).

Për kriterin e sipërcituar OE ka paraqitur vetëm për punonjësit e kërkuar në pikën 2.8 dhe jo për pikën 2.7 Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/ të kualifikuar**, si më poshtë duhet të jetë në listëpagesat e muajit Prill 2025- Qershor 2025

- 1 **Teknik Ndërtimi**
- 5 **Elektricitist**
- 2 **Hidraulik**
- 3 **Bojaxhi**
- 2 **Betonues**
- 2 **Karpentier**
- 1 **Hekurkthyes**
- 2 **Muratore**

- 4 **suvaxhi**
- 1 **Gurepunues**
- 1 **Hidroizolues**
- 3 **Termoizolues**
- 1 **Specialist IT**
- 2 **Specialist konstruksione metalike**
- 1 **Specialist punime druri**
- 1 **Specialist punime gipsi**
- 2 **Specialist sistemet ngrohje-ftohje**
- 4 **Pllakashtrues**
- 1 **Shtrues laminat/parketi**
- 1 **Mekanik**
- 1 **Saldatori**
- 1 **Specialsit duralumini**

2.4 Operatori ekonomik pjesmarrës për realizimin e punimeve duhet të jete i pajisur me Licencë për veprimtarinë ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale në Zbatim (Z)

Kategoria; Licencë për kryerjen e veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale, të arkitekturës/ndërtimore – (A);

Nënkategoria Z/A/4. Zbatim në konservim dhe restaurim i ndërtimeve inxhinierike;
Nënkategoria Z/A/7. Zbatim në konservim, restaurim dhe rikualifikim i hapësirave (rrugë, sheshe)brenda qendrave historike dhe ansambleve historike urbane

Në marrëveshjen e bashkëpunimit midis palëve në ndarjen e zërave të punimeve që I përkasin licencës së sipërcituar operatorët janë ndarë si mëposhtë:

				NIKA	B.M- Konstruksion
An. 1	Termoizolim fasade me lesh xhami / guri t=10cm, densitet 130 kg/m3 + rrjete suvatimi + grafiato	m2	1220	90%	10%

An. 2	Çati me strukture druri klasa C35 - D35 sipas EN 338:2003, perfshi termoizolim me lesh xhami dhe hidroizolim, sipas detajit	m2	706	90%	10%
An. 3	Stola ne ambjentet e jashmte me strukture metalike dhe lende druri	copë	21	90%	10%
An. 4	Struktura metalike per koshin e basketbollit, perfshi instalimin dhe rrjetat (çift)	copë	1	90%	10%
An. 5	Struktura metalike per rrjeten e volejbollit, perfshi instalimin dhe rrjetat (çift)	copë	1	90%	10%
An. 6	F.V. Shtrese elastike ne zonen e fushave sportive (tartan me trashesi t= 15 mm)	m2	225	90%	10%
An. 7	Cukitje e pastrim i suvase se brendshme ekzistuese, aplikim shtrese rrjete plastike te fiksuar me kolle per unifikimin e siperfaqeve	m2	4470	90%	10%

Përsa më sipër OE Nika shpk nuk ka të paraqitur Licencë për veprimtarinë ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale në Zbatim (Z) Nënkatëgoria Z/A/4/7 për punimet e mësipërme.

Si rrjellojë BOE “NIKA” sh.p.k & “B.M-Konstruksion” sh.p.k s’kualifikohet.

(b) **BOE T&J Construction sh.p.k me NIPT M29718101T & VALONA KONSTRUKSION sh.p.k me NIPT K26330202E & NDREGJONI sh.p.k me NIPT K31329048I me vlerë të ofertës së ofruar 65 000 000 (Gjashtëdhjetë e pesë milion) lekë pa tvsh.**

BOE T&J Construction SHPK & VALONA KONSTRUKSION SHPK & NDREGJONI SHPK në formularin e ofertës së tyre:

- Në Seksionin 2 Punime mekanike në pjesën përmbledhëse ka ndryshuar formatin duke I shtuar tvsh pajisjeve mekanike të cilat në bazë të Ligjit nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, I ndryshuar janë të përjashtuara nga tvsh.
- Në Seksionin 3 Punime elektrike Pajisjet pa tvsh në shitje (8) nuk llogariten në fond rezerve por llogariten si Pajisje me tvsh jashtë fondit rezervë.
- Në tabelën përmbledhëse të tre Seksioneve të preventivit formati I kërkuar nga ana e AK është si mëposhtë:

SHUMA ANALIZA PA TVSH
SHUMA TVSH (20%)
SHUMA ANALIZA ME TVSH (20%)
SHUMA E PAJISJEVE PA TVSH NE SHITJE (Shuma 7, Seksioni B i pajisjeve mekanike)
SHUMA TOTALE PA TVSH : (SHUMA ANALIZA <u>PA</u> TVSH +SHUMA E PAJISJEVE PA TVSH NE SHITJE (Shuma 7, Seksioni B i pajisjeve mekanike)
SHUMA TOTALE ME TVSH :(SHUMA ANALIZA <u>ME</u> TVSH+ SHUMA PAJISJE MEKANIKE PA TVSH (Shuma 7, Seksioni B i pajisjeve mekanike)

Ju keni ofertuar me format të ndryshuar si mëposhtë:

Shuma A+C
Fondi rezerve 5%
Shuma analiza
shuma tvsh 20%
Shuma me tvsh AC
Shuma pajisje pa tvsh ne shitje 8
shuma tvsh per pajisje
shuma pajisje me tvsh ne shitje 8

shuma pajisje pa tvsh ne shitje 7
shuma tvsh per pajisje
shuma pajisje me tvsh ne shitje 7
Vlera totale pa tvsh
Vlera totale me tvsh

- Në “shuma analiza” mungon vlera e pajisjeve pa tvsh në shitje (8).
- Në “ Shuma tvsh për pajisje 7 ” dhe “Shuma pajisje me tvsh ne shitje 7 ” vlerë e shtuar në kundërshtim me Ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, I ndryshuar
- **Vlera totale me tvsh llogaritur në kundërshtim me formën e kërkuar nga AK (SHUMA TOTALE ME TVSH :(SHUMA ANALIZA ME TVSH+ SHUMA PAJISJE MEKANIKE PA TVSH (Shuma 7, Seksioni B i pajisjeve mekanike)) por e llogaritur shumëzim për 20%**

Përsa më sipër në Nenin 92 pika 1 i Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” përcakton se 1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohej, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme

Neni 82 i VKM nr. 285, datë 19.05.2021 përcakton se autoriteti kontraktor mund të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, por jo ndryshime të strukturës apo përmbajtjes së ofertës.

Ndryshimi i preventivit përbën **mospërputhje thelbësore** me kërkesat e DST dhe sjell pamundësi për krahasim të barabartë midis operatorëve ekonomikë, duke cenuar parimin e barazisë dhe transparencës në garë. Ne kete rast konsiderohet si **parregullsi formale**

- OE T & J Construction shpk në marrëveshjen e bashkëpunimit të deklaruar në preventivin e ndarjes së punimevë deklaroi se do të marrë përsipër zërat e punimeve

3.961	F.V. Fidane Peme dekorative	copë	25
3.962	F.V. Fidane shkurre dekorative "Oleander"	copë	40

Të cilat I përkasin punime të pikës së licencës N.P-12 A Punime të inxhinierisë së mjedisit. OE nuk rezulton të ketë këtë pikë të licencës në licencën e tij.

2.5 Operatori ekonomik pjesmarrës për realizimin e punimeve duhet të jete i pajisur me Licencë për veprimtarinë ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale në Zbatim (Z)

Kategoria; Licencë për kryerjen e veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale, të arkitekturës/ndërtimore – (A);

Nënkategoria Z/A/4. Zbatim në konservim dhe restaurim i ndërtimeve inxhinierike;
Nënkategoria Z/A/7. Zbatim në konservim, restaurim dhe rikualifikim i hapësirave (rrugë, sheshe)brenda qendrave historike dhe ansambleve historike urbane

- Në marrëveshjen e bashkëpunimit midis palëve në ndarjen e zërave të punimeve që I përkasin licencës së sipërcituar operatorët janë ndarë zërat si mëposhtë:

An. 1	Termoizolim fasade me lesh xhami / guri t=10cm, densitet 130 kg/m3 + rrjete suvatimi + grafiato	m2	1220	Valona
An. 2	Çati me strukture druri klasa C35 - D35 sipas EN 338:2003, perfshi termoizolim me lesh xhami dhe hidroizolim, sipas detajit	m2	706	Valona
An. 3	Stola ne ambjentet e jashmte me strukture metalike dhe lende druri	copë	21	Valona
An. 4	Struktura metalike per koshin e basketbollit, perfshi instalimin dhe rrjetat (çift)	copë	1	Valona
An. 5	Struktura metalike per rrjeten e volejbollit, perfshi instalimin dhe rrjetat (çift)	copë	1	Valona
An. 6	F.V. Shtrese elastike ne zonen e fushave sportive (tartan me trashesi t= 15 mm)	m2	225	Valona
An. 7	Cukitje e pastrim i suvase se brendshme ekzistuese, aplikim shtrese rrjete plastike te fiksuar me kolle per unifikimin e siperfaqeve	m2	4470	Ndregjoni

Përsa më sipër OE Ndregjoni shpk nuk ka të paraqitur Licencë për veprimtarinë ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale në Zbatim (Z) Nënkategoria Z/A/4/7

- OE T & J Construction shpk në Formularin përmbledhës të vetdeklarimit ka deklaruar punonjës in Faik Deliu njëkohësisht dhe teknik ndërtimi dhe gurëgdhëndës(gurëpunues).

Në preventivin e ndarjes së punimeve rezulton se për zërin

Veshje pllaka guri 50x40 cm; 50x50 cm	m2	205
--	----	-----

Për të cilin kërkohet gurëgdhëndës (gurëpunues) dhe zë të cilin e ka marrë përsipër OE T & J Construction shpk nuk mund të deklarojë të njëjtin punonjës për dy profesione të ndryshme si teknik ndërtimi dhe gurëgdhëndës (gurëpunues) njëkohësisht.

Si rrjedhojë **BOE: “T&J Construction” sh.p.k & “VALONA KONSTRUKSION” sh.p.k & “NDREGJONI” sh.p.k s’kualifikohet.**

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë

INA shpk me Nr Nipti J61814009W me 89 % , dhe adresa Tirane TIRANE Rruga Besim Imami, Myslym Shyri, Mbrapa Karburantit]

EUROBETON shpk me Nr Nipti K23116602P me 11% dhe adresë Gjirokaster GJIROKASTER Ndane rruges nacionale Gjirokaster-Kakavie, perballe Varrezave te qytetit Gjirokaster, godine 2-kateshe, nr. pasurie 19/5, Zona Kadastrale 8543

me Subjekt Mbështetës:

2 N shpk me Nr Nipti L31615017L me adresë Tirane Paskuqan PASKUQAN Lagjja "Paskuqan Fushe", Rruga "Demokracia", Pallati Nr.2, Kati i Pare

se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 61.957.475,65 *[gjashtëdhjetë e një milion e nëntëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e pesë presje gjashtëdhjetë e pesë]*lekë pa tvsh / totali i pikëve të marra [_____] është identifikuar si ofertues i sukseshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

ZYRTARI I AUTORIZUAR I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Nertil Nebiaj